



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 243/1 Prot.

Tiranë, më 06.02.2024

**V E N D I M**

**Nr. 37, Datë 06.02.2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 135, datë 29.06.2023, e K.V, i përfaqësuar nga Avokate S.P<sup>1</sup> kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes familjare<sup>2</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash, informon se: “*Kam ardhur në dijeni të faktit që jam skualifikuar nga procesi i konkurrimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë me argumentin se nuk mund të plotësoj kriteret ligjore për të qenë pjesë në Akademinë e Sigurisë. Me shkresën nr. 321/2-K, datë 05.06.2023, jam njoftuar për skualifikim, arsyeja është që në verifikimin përfundimtar në të cilin duhet të dokumentoj faktin se unë apo pjesëtarë të familjes nuk jemi të implikuar në veprimtari kriminale gjë të cilën e kam dokumentuar, por nga burime të tjera jozyrtare jam vënë në dijeni se arsyeja e skualifikimit në Akademinë e Sigurisë është xhaxhai im, B.V i cili është dënuar me vendim të formës së prerë me 6 muaj burg. Unë si person nuk rezultoj nga certifikata familjare, me të njëjtin person, pra me xhaxhain tim dhe nuk kam asnjë lloj kontakti me të. Ndaj ai nuk bën pjesë në bërthamën e familjes time. Gjithashtu theksoj se asnjë nga familjarët e mi nuk është i inkriminuar apo i përfshirë në veprimtari kriminale”.*

<sup>1</sup> Referuar Prokurës së Posaçme, nr. repertori 774, nr. koleksioni 329, datë 08.06.2023, të noterit E. P. B.

<sup>2</sup> Për shkak se xhaxhai i tij B.V, ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave të nevojshme.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 135, datë 29.06.2023, të bërë nga K.V, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 771/2, datë 04.07.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga DPPSH për ankesën e bërë dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:

<sup>3</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

- Informacion lidhur me arsyet për të cilat ankuesi nuk është kualifikuar për të vijuar studimet në Akademinë e Sigurisë.
- Kopje të procedurës së ndjekur nga ana e Komisionit të Pranimi, për skualifikimin e ankuesit.
- Kopje të dokumentit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e besueshmërisë së K.V, ku cilësohen arsyet pse kandidati është i papërshtatshëm për vijimin e studimeve në Akademinë e Sigurisë.
- Informacion dhe dokumentacion shoqërues me anë të të cilit të provohen arsyet e skualifikimit të K.V nga konkurrimi për në Kolegjin e Policisë.
- Informacion lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore (si dhe kopje të tyre), në të cilat është e parashikuar procedura që ndiqet për verifikimin e besueshmërisë për kandidatët për punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit.

Me shkresën nr. 6062/1, datë 19.07.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Nga të dhënat e administruara në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore rezulton se K.V, ka qenë aplikant në konkurrimin për pranim në Kolegjin Profesional të Formimit Policor, në Akademinë e Sigurisë. Pas verifikimit mbi plotësimin e kriterëve të parashikuar në nenin 38, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, është përzgjedhur për të vazhduar fazat e konkurrimit të parashikuara në pikën 1, të nenit 135 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, e ndryshuar, ku përcaktohet:*

*“1. Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimi në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet fazave të konkurrimit sipas rendit të mëposhtëm:*

- a) testimit me shkrim;*
- b) testimit të aftësive fizike;*
- c) intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimit të aftësive të shkruarit;*
- ç) testimit psikologjik;*
- d) kontrollit shëndetësor;*
- dh) marrjes së shenjave të gishtave;*
- e) verifikimi përfundimtar i aplikantit.*

*K.V pasi kaloi me sukses procesin e testimeve dhe kontrollin shëndetësor, iu nënshtrova verifikimit përfundimtar, për të dokumentuar faktin nëse ai apo pjesëtarë të familjes së tij, nuk janë të implikuar në veprimtari kriminale. Procedura e verifikimit përfundimtar të aplikantit është parashikuar në nenin 139 të Rregullores së Policisë së Shtetit, ku përcaktohet: “Në rast se aplikanti ose pjesëtarë të familjes së tij, pas verifikimit përfundimtar, rezultojnë të implikuar në veprimtari kriminale, ai skualifikohet dhe procesit të verifikimit përfundimtar i nënshtrohet kandidati i radhës, i renditur në listën e rezultateve, sipas rendit zbritës.*

*Bazuar në dispozitat e sipërcituara, strukturat kompetente të hetimit të krimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë kanë kryer procedurat e verifikimit, nga ku ka rezultuar se shtetasi K.V nuk është i përshtatshëm për t’u pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit.*

*Mbi këtë bazë, Komisioni i Pranimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me Vendimin nr. 500/2, datë 05.06.2023, ka vendosur mospranimin e shtetasit K.V në Kolegjin Profesional të Formimit Policor, në Akademinë e Sigurisë. Mbi këtë vendim K.V është njoftuar zyrtarisht me shkresën nr. 321/2-K, datë 05.06.2023”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 771/4, datë 26.09.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 05.10.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi kopje të dokumentacionit, si më poshtë:
  - Kopje të dokumentit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e besueshmërisë së K.V, ku cilësohen arsyet pse kandidati është i papërshtatshëm për vijimin e studimeve në Akademinë e Sigurisë.
  - Informacion dhe kopje të dokumentacionit shoqërues me anë të të cilit të provohen arsyet e skualifikimit të K.V nga konkurrimi për në Kolegjin e Policisë.
  - Informacion lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore (si dhe kopje të tyre), në të cilat është e parashikuar procedura që ndiqet për verifikimin e besueshmërisë për kandidatët për punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit.

Seanca u zhvillua në datë 05.10.2023, vetëm me praninë e subjektit ankues, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit megjithëse kishte marrë dijeni nëpërmjet njoftim marrje poste me nr. RR 454 404 313 AA, datë 27.09.2023, nuk u paraqit në seancën dëgjimore dhe nuk dërgoi dokumentacionin e kërkuar.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

- Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 771/5, datë 19.10.2023, iu drejtua sërish DPPSH-së, me një kërkesë për dokumentacion dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
  - Kopje të dokumentit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e besueshmërisë së K.V, ku cilësohen arsyet pse kandidati është i papërshtatshëm për vijimin e studimeve në Akademinë e Sigurisë.
  - Informacion dhe kopje të dokumentacionit shoqërues me anë të të cilit të provohen arsyet e skualifikimit të K.V nga konkurrimi për në Kolegjin e Policisë.
  - Kopje të përgjigjes së DPPSH, lidhur me ankesën e bërë nga K.V në datë 08.06.2023 kundër vendimit të skualifikimit nga procesi i konkurrimit (neni 141, pika 1 e Rregullores së Policisë së Shtetit).
  - Informacion lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore (si dhe kopje të tyre), në të cilat është e parashikuar procedura që ndiqet për verifikimin e besueshmërisë për kandidatët për punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka marrë dijeni për shkresën nr. 771/5, datë 19.10.2023, në datë 23.10.2023, fakt ky që rezultoi i provuar nga lajmërimi marrja e shërbimit postar nr. RR520172839AA administruar në dosje, por nuk ka kthyer përgjigje.

Me shkresën nr. 25/1, datë 08.01.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar DPPSH-në me Vendimin nr. 03, datë 08.01.2024, në të cilin institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është gjobitur në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë për mosdhënien e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga K.V.

Me shkresën e klasifikuar sekret nr. 134, datë 11.01.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka dërguar pranë Komisionerit, informacionin e kërkuar sipas Vendimit nr. 03, datë 08.01.2024.

Në vijim Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin nr. 19, datë 16.01.2024, shfuqizoi Vendimin me gjobë nr. 03, datë 08.01.2024 dhe vendosi vazhdimin e procedurës së shqyrtimit të ankesës.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij*”.

## **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Mbështetur në nenet 37 dhe 38, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Urdhrit nr. 294, datë 23.02.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për ri hapjen e aplikimeve për konkurrim, për pranim në Kolegjin Profesional të Formimit Policor në Akademinë e Policisë”, K.V ka konkuruar për të studiuar pranë Akademisë së Sigurisë.

Në nenin 135, të Rregullores për Policinë e Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, përcaktohen të gjitha fazat e konkurrimit për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë. Neni i sipërcituar parashikon: “1. Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimin në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet fazave të konkurrimit sipas rendit të mëposhtëm:

- a) testimin me shkrim;
- b) testimin të aftësive fizike;
- c) intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimin të aftësive të shkruarit;
- ç) testimin psikologjik;
- d) kontrollin shëndetësor;
- dh) marrjes së shenjave të gishtave;
- e) verifikimi përfundimtar i aplikantit”.

Rezulton se K.V ka kaluar me sukses të gjitha fazat e konkurrimit për në Akademinë e Policisë, duke mbërritur në fazën e Verifikimit Përfundimtar. Në nenin 139, të Rregullores për Policinë e Shtetit miratuar me Vendimin nr. 750, datë 16.09.2015, të Këshillit të Ministrave, parashikohet se:

*“1. Aplikanti që kalon me sukses procesin e testimin të përcaktuar në nenin 135, germa “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të kësaj rregulloreje, i nënshtrohet procesit të verifikimit përfundimtar, për të dokumentuar faktin që ai, ose pjesëtarë të familjes së tij, nuk janë të implikuar në veprimtari kriminale.*

*2. Numri i aplikantëve që do t’i nënshtrohen procesit të verifikimit, sipas pikës 1 të këtij neni, është i njëjtë me kuotën për konkurrim të përcaktuar në fillim të procesit.*

*3. Në rast se aplikanti ose pjesëtarë të familjes së tij, pas verifikimit përfundimtar, rezultojnë të implikuar në veprimtari kriminale, ai skualifikohet dhe procesit të verifikimit përfundimtar i nënshtrohet kandidati i radhës, i renditur në listën e rezultateve, sipas rendit zbritës.*

*4. Verifikimi kryhet nga strukturat vendore dhe qendrore të hetimit të krimit, sipas procedurave të miratuara nga Drejtoria e Policisë së Shtetit.*

*5. Relacioni (lidhja 17) me dokumentacionin e çdo aplikanti fitues, i dërgohet Akademisë së Sigurisë”.*

Mbështetur në parashikimin e nenit 139, të sipërcituar, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ka kryer procedurat e verifikimit, nga ku ka rezultuar se shtetasi K.V nuk është i përshtatshëm për t’u pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Pranimin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me Vendimin nr. 500/2, datë 05.06.2023, ka vendosur të s’kualifikojë (gjithsej 37 shtetas) nga

procesi i pranimit në Akademinë e Sigurisë shtetasin K.V, për shkak se nuk gëzon besueshmëri për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit.

Me shkresën nr. 321/2-K, datë 05.06.2023 të DPPSH-së, K.V është njoftuar për skualifikimin e tij nga procesi i konkurrimit për pranimin në Akademinë e Policisë.

Përgjatë hetimit administrativ, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën e klasifikuar sekret nr. 134, datë 11.01.2024, ka dërguar informacionin e kërkuar nga Komisioneri.

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 *“Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”*”, i ndryshuar<sup>4</sup>, informacioni i dërguar nga DPPSH, për shkak të natyrës është konsultuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Nga ana e Komisionerit përgjigja e dhënë nga DPPSH është vlerësuar si informacion i cili i ka dhënë përgjigje arsyes së s’kualifikimit të shtetasit K.V nga procesi i konkurrimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se nuk ka tagër të vlerësojë shkakun/arsyen e dhënë nga DPPSH-ja për këtë rast, por merr të mirëqenë informacionin e dhënë nga institucioni lidhur me besueshmërinë e aplikantit për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit. Për më tepër Komisioni i Pranimit në këtë proces verifikimi nuk ka s’kualifikuar vetëm subjektin ankues, por ka s’kualifikuar dhe 36 aplikantë të tjerë të cilët nuk gëzonin besueshmëri për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit.

Komisioneri për shkak të informacionin që është i klasifikuar sekret, nuk mund të japë të dhënat e këtij informacioni, për shkakun e s’kualifikimit të ankuesit.

Komisioneri në përfundim të shqyrtimit të informacionit, vlerëson se vendimi i marrë nga Komisioni i Pranimit të DPPSH-së kundrej ankuesit, ka një justifikim të arsyeshem dhe objektiv.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në nenin 17/2 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet t’i refuzohet një personi ose grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit, si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër*

---

<sup>4</sup> Neni 22 Autorizimi dhe Ndalimi *“Një institucion nuk ka të drejtë të zbulojë informacionin origjinal të klasifikuar nga një institucion tjetër pa autorizimin e këtij të fundit”*.

*personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e subjektit ndaj të cilit ka paraqitur ankesën.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të K.V për shkakun e pretenduar, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**